



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 88, datë 27.07. 2020

“PËR

**MIRATIMIN E LISTËS SË RISHIKUAR TË INVENTARIT TË SIPËRFAQEVE TË FONDIT
PYJOR DHE KULLOSOR, TRANSFERUAR NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 3, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “a dhe pika 1 nënpika 1.2, shkronja “a”, nenit 27, pika 5, nenit 54 shkronjat “e”, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 15, pika 3, gërma “a”, të Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”; nenit 5, pika 1, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar; pikës 52, të Vendimit nr. 433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”; Vendimit nr. 632, datë 11.06.2009 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”; udhëzimit nr. 2, datë 20.07.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”; Vendimit nr. 28, datë 23.05.2016, “Për kalimin e funksioneve të mirëmbatjes së rrugëve rurale, ujitjes dhe kullimit pranë Drejtorisë së Përgjithëshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, si dhe administrimit të pyjeve dhe kullotave pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”, të ndryshuar; shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me nr. 11423 prot., datë 30.12.2019 (protokolluar në Bashkinë Tiranë me nr. 21 prot., datë 06.01.2020), si dhe në vijim të shkresës nr. 21/3, datë 18.05.2020 nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së rishikuar të inventarit të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullor, transferuar në pronësi të Bashkisë Tiranë sipas shtojcës nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.Ngarkohet Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

3.Ngarkohet Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik për përcjelljen e këtij vendimi pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për vijimin e procedurave të mëtejshme.

4.Ky Vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

TONI GOGU